

RELACIONI TEKNIK ELEKTRIK

Objekti: "Ndertim Kopesht dhe cerdhe e interguar Nr.50, në Bashkine Tirane".

I. KERKESA TE PERGJITHSHME

1.1.- Hyrje

a.-Objekti

Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objektit

Vendndodhja: Objekti ndodhet në rrugën "Besim Daja", në Njësinë Administrative Nr. 8.

Përshkrim: Ndërtesa, e cila ka funksionuar para viteve 90 si kopësht, dhe më pas është shfrytëzuar si banesë, aktualisht është e amortizuar dhe e prishur pjesërisht nga IMT-ja.

Sipërfaqja totale ndërtimore e gjurmës, në zotërim të Bashkisë Tiranë, është 668.46 m², në të cilën 288.42 m² është sipërfaqja e gjurmës së ndërtesës aktuale. Pas verifikimit nga specialistët e Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike u konstatua se në këtë truall ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një kopshti dhe çerdheje të integruar.

Kapaciteti: Kopshti duhet të akomodojë 80- 100 fëmijë, ndërsa çerdhja 50- 60 fëmijë, duke marrë në konsideratë që sipërfaqja për fëmijë të motakët është 8 m²/ fëmijë dhe për latantët 7.6 m²/ fëmijë.

b.- Qellimi i projektit

Qellimi i këtij projekti janë instalimet e sistemeve elektrike dhe elektronike të parashikuara në objekt në përputhje me të gjithë ligjet, VKM-te, standardet, kodet (kushtet teknike) dhe rregulloret teknike në fuqi.

Specifikimet e mëposhtme përfshijnë ato pjesë të kontratës e cila konsiston në furnizimin e të gjitha materialeve, pajisjeve, puntorise dhe të gjithë shërbimeve të tjera që kerkohen për të realizuar këto sisteme inxhinjerie të kompletuara, funksionale dhe të sigurta.

Realizimi me sukses i këtyre specifikimeve dhe kërkesave në përputhje me të gjithë ligjet, VKM-te, standardet, kodet (kushtet teknike) dhe rregulloret teknike në fuqi si dhe respektimi i rekomandimeve të prodhuesve të pajisjeve dhe materialeve që parashikohet të instalohen është detyrë e zbatuesit - Kontraktorit. Përpara fillimit të punimeve, Kontraktori duhet të paraqesë për aprovim programin e punimeve së bashku me metodologjinë për një punë cilësore dhe të sigurtë për puntorinë. Ai duhet të paraqesë për aprovim edhe të gjithë elementet e tjera të nevojshme për kryerjen e punës sipas gjykimit të tij apo kërkesave teknologjike.

1.2.- Sigurimi i Cilesise

Sistemet inxhinjerieke që do të furnizohen sipas këtyre specifikimeve do të jete një produkt standard i një prodhuesi të njohur prej vitesh dhe të konsoliduar në prodhimin e materialeve elektrike, elektronike dhe të sistemeve të integruara të sigurise.

Sistemet inxhinjerieke të furnizuar dhe pjesët perberese të tyre duhet të jene prodhime të viteve të fundit, të kataloguar dhe të prodhuar

ne perputhje me standardet kombetare, nderkombetare dhe europiane te cilesise dhe sigurise. Per te marre aprovimin, kontraktori duhet te paraqese te dhena te sakta per sistemet qe furnizon dhe projektin e detajuar per aprovim.

Garancita e instalimeve, paisjeve e sistemeve te furnizuara duhet ti dorezohen Inxhinjerit Supervizor me perfundimin e instalimeve, perpara procedurave te pranimit dhe dorezimit te punimeve.

1.3.- Furnizimi i Produktit, Magazinimi dhe Perdorimi

Paisjet elektrike dhe elektronike nuk duhen te instalohen ne kantier deri sa kushtet e ambientit nuk jane plotesuar per kete qellim. Per produktet qe instalohen pa u plotesuar kushtet e duhura mund te kerkohet nga Inxhinjeri Supervizor qe te zevendesohen pa marre persiper rimbursimin e koston se tyre.

1.4.- Procedura e Pranimit te Punimeve

Pas perfundimit te instalimit, kontraktori duhet filloje provat dhe kalibrimin e sistemit inxhinjrik.

Testimi i sistemit duhet te behet ne prani te Inxhinjerit Supervizor. Testimi i sistemit nenkupton venien ne pune te sistemit sipas radhes se duhur dhe ne perputhje te plote me standardet, rregullat dhe rekomandimet e prodhuesit. Kontraktori duhet te beje ne fillim nje testim paraprak per sistemin perpara se te kerkoje realizimin e testit per dorezim te punimeve. Vetem atehere kur provohet se puna e sistemit apo e produktit eshte e kenaqshme teresisht apo plotesisht atehere sistemi apo produkti apo pjeset te tij do te pranohen per perdorim.

1.5.- Provat

Kontraktori do te jete pergjegjesi per koordinimin dhe kryerjen e provave perpara marrjes ne dorezim te objektit. Pas perfundimit te instalimit, kontraktori duhet te njoftoje minimumi nje jave para Inxhinjerin Supervizor qe sistemi eshte testuar ne menyre te kenaqshme nga ana e grupit te inxhinjereve te kontraktuesit dhe/ose nga perfaqesuesi i prodhuesit dhe eshte gati per proven perfundimatare dhe procedurat e marrjes ne dorezim. Gjate kohes se deklarimit kontraktori do te paraqesi vizatimet "As-Built Drawings" per projektin e realizuar dhe "Planin e provave" ku do te pershkruaje ne menyre te detajuar menyren e testimit te sistemit te realizuar.

Plani i provave duhet te permbaje hap-pas-hapi te gjitha pershkrimet e testimave qe do te kryhen. Ai duhet te tregojte se keto prova vertetojne se kerkesat e instalimit dhe funksionimit te sistemit jane permbushur.

1.6.- Projekti se si eshte ndertuar sistemi (As build drawings)

Kontraktuesi duhet ti dorezoje Inxhinjerit Supervizor dy (2) kopje te projektit "as build" dhe dy (2) kopje elektronike te tij pas perfundimit te punimeve.